



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. nr.240/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2571/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.474/2019 të datës 19.08.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr."Mbreti Pirro" B.C, Kati II, Nr.6, Pejë, kundër organit të punësimit Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka", në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.474/2019 e datës 19.08.2019, e parashtruar nga ankuesja**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 1943 i datës 22.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.**

A r s y e t i m

Ankuesja përmes postes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 19.08.2019 me numër protokolli 3646/2019 e regjistruar me numër A.nr.474/2019, kundër Vendimit me numër protokolli 1943 të datës 22.07.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 26.08.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë më datë 09.09.2019 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3646/2019 të datës 19.08.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me

Nr.1943 të datës 22.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë; Ankesën me nr.1610 të datës 25.06.2019 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka"; Kopjen e konkursit me nr.1085 të datës 03.05.2019; Kontratën e Punës me nr.1/855 e datës 05.06.2009; Akt Emërimit me nr.1/872 i datës 28.06.2012; Marrëveshje Mirëkuptimi me nr.0113 të datës 22.08.2012; Vendimin e datës 06.05.2014 me nr.01-579/14; Akt Emërimit me nr.1785 i datës 27.07.2017; Detyrat e Emërimit; Vendimi i datës 07.11.2018 me Nr.2945; Kopja e letërnjoftimit; kopja e E-mailit zyrtar të datës 19.08.2019; Konkurs për staf administrativ për plotësimin e pozitës me nr.520 i datës 15.05.2019; Kërkesa për punësim bashkë me dokumentet e kërkuara për e datës 15.05.2019; Konkurs për staf administrativ për plotësimin e pozitës me nr.529 i datës 16.05.2019; Kërkesa për punësim bashkë me dokumentet e kërkuara për e datës 16.05.2019; Procesverbali i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 01.07.2019; Procesverbal i datës 05.07.2019; Procesverbali i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 11.07.2019; Autorizimi i MAP-it i datës 30.04.2019; Njoftim për kandidatin e suksesshëm me nr.1364 i datës 30.05.2019; Kërkesë për Autorizimin e inicimit të procedurës së rekrutimit e datës 30.04.2019; Form.MAP-SHCK-11-Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 29.05.2019; Form.MAP-SHCK-10 -Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 23.05.2019; Form.MAP-SHCK-09-Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Form.MAP-SHCK-08a-Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Form.MAP-SHCK-07a -Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj ; Form.MAP-SHCK-06-Njoftimi i kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë i datës 21.05.2019; Form.MAP-SHCK-05-Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Form.MAP-SHCK-04-Regjistri i aplikacioneve të pranuar prej datës 03.05.2019-17.05.2019; Form.MAP-SHCK-02-Shpallja e rekrutimit; Form. MAP-SHCK-01 - Kërkesë për Fillimin e Rekrutimit e datës 30.04.2019; Deklarim rreth formimit të Komisionit ad-hoc përzgjedhës për pozitën Sekretar i Njesisë Akademike -Fakulteti i MTHM-së i datës 08.05.2019; Vendimi me nr.1210 i datës 16.05.2019 për themelimin e Komisionit përzgjedhës; Kopja e testit me shkrim i datës 23.05.2019; Njoftimi i datës 30.05.2019; Njoftimi i datës 30.05.2019; Njoftimi i datës 30.05.2019; Njoftimi për Intervistë i datës 24.05.2019; Njoftimet për mbajtjen e testit me shkrim i datës 20.05.2019; Raporti final për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm i datës 30.05.2019; Njoftim lidhur me testimin me shkrim për konkurset e shpallura nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë e datës 22.05.2019; Njoftim për shpalljen e konkurseve për pozitën drejtuese nga Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë e datës 08.05.2019; Lista e kandidatëve për pozitën Sekretar i Njesisë Akademike-Fakulteti i MTHM-së dhe Përgjigje në ankesë e datës 09.09.2019 nga organi i punësimit me numër protokollit 4242/2019; E-mail nga M.H. për B.G. i datës 22.04.2021; Autorizimi i MAP-it i datës 06.03.2019; Konkurs i Brendshëm me nr. 442 i datës 06.03.2019; ankesën A. Nr,240/2021, të datës 01.04.2021, sipas Aktgjykimit A.Nr. 2571/2019, të datës 22.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë / Departamenti për Çështje Administrative; Njoftim me nr.4769 i datës 11.10.2019; Pliko me nr. R7511829 i datës 19.08.2019; Shkresë numër protokollit 699 e datës 26.03.2019, Raporti Final i Komisionit Përzgjedhës i datës 25.03.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" në bazë të Autorizimit të datës 30.04.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e

Administratës Publike, me datë 03.05.2019 ka shpallur konkursin me numër UHZ Nr.014, për pozitën "Sekretar i Njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM". Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej shtatë (7) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesen e cila i është nënshtruar të gjitha fazave të rekrutimit, por që nuk ka arritur të përzgjidhet si kandidat e suksesshëm për këtë pozitë. Në listë të ngushtë janë përfshirë 5 kandidatë, të cilët janë ftuar për fazat e mëtejme të vlerësimit gjegjësisht testin me shkrim i mbajtur me datë 23.05.2019 dhe intervistën me gojë më datë 29.05.2019. Komisioni Përzgjedhës i themeluar sipas Vendimit numër protokollit 1210 të datës 16.05.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka, për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Sekretar i Njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM", në Listën e Vlerësimit përfundimtar ka vlerësuar si kandidatë me më shumë pikë me gjithsej 75.76 pikë. Bazuar në këtë vlerësim, Zyra e Personelit të Universitetit "Haxhi Zeka " ka shpallur Njoftimin për kandidatin e suksesshëm përmes shkresës me numër protokollit 1364 të datës 30.05.2019. Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 30.05.2019 për kandidatin e suksesshëm, me datë 25.06.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1610 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka, i cili me Vendimin numër protokollit 1943 të datës 22.07.2019, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuses.

Ankuesja kundër Vendimit numër protokollit 1943 të datës 22.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka, ka parashtruar ankesë me datë 19.08.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve thelbësore të së drejtës procedurale. Pretendon se konkursi i jashtëm për pozitën "Sekretar i Njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM" është shpallur ende pa përfunduar procedura e mjeteve juridike lidhur me konkursin e brendshëm për këtë pozitë, Komisioni Përzgjedhës nuk është formuar në pajtim me Rregulloren Nr.02/010 për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civil, në testin me shkrim nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi i KPMSHC siç parashihet me Rregulloren Nr.03/2018 Për Rregullat dhe Procedurat e Mbikëqyrjesh së Përzgjedhjes së Nëpunësve Civil të Nivelit të Lartë Drejtues dhe Nivelit Drejtues. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe procedurën e rekrutimit për pozitën "Sekretar i Njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM".

Për pozitën e shpallur "Sekretar i Njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM-Universiteti " Haxhi Zeka" në Pejë, me numër UHZ Nr.014 të datës 03.05.2019, kritere kryesore të konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universiteti-Fakulteti Juridik dhe Biznesi;*
- *4 vite përvojë pune pas diplomimit,*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën "Sekretar i Njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM", është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil dhe Rregulloren NR.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civilë.

Përkitazi me kërkesat themelore të konkursit, Kolegji nga shqyrtimi i dosjes së aplikimit ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur ka plotësuar kushtet referuar konkursit me numër UHZ Nr.014 të datës 03.05.2019 dhe se e njëjta posedon: Certifikatë të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti Juridik me numër Ref. R-41/0-05/121 e datës 01.04.2008, më të cilin dëshmohet së ka të përfunduar Fakultetin Juridik, dhe ka marrë titullin Bachelor i Drejtësisë, - Diplomë të Universitetit të Prishtinës Nr. 745 të datës 25.11.2014 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet Master drejtimi Civil- Juridik dhe ka fituar titullin Ma.Sc i Juridikut- Civil,

ndërsa lidhur me përvojën e punës pas diplomimit kandidatja e zgjedhur posedon: Rekomandim nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nr.prot: 388/15 të datës 28.04.2015 me të cilin vërtetohën sa ka punuar pranë kësaj Ministrie në pozitën e Zyrtares për Punë Sociale në Qendrën për Punë Sociale në Pejë nga data 01.08.2014 deri me 31.12.2014, Vërtetim nga Oda e Avokateve të Kosovës me nr. 150/2016 të datës 29.01.2016, me të cilin dëshmohet se ka kryer praktikën e Avokatit në Zyrën e Av. gjatë periudhës 30.01.2015 deri 29.01.2016, Dëshmi-Rekomandim nga Zyra Përmbartimore BK Partneres Sh.P.K me të cilin konfirmohet se punon si zyrtare Përmbartuese nga 5 shtator 2016 e tutje dhe se kjo përvojë dëshmohet edhe me Pasqyrën e TRUST-it.

Lidhur me pretendimin ankimor, se konkursi i jashtëm për pozitën Sekretar i Njesisë Akademike-Fakulteti i MTHM, është shpallur ende pa përfunduar procedura e mjeteve juridike të konkursit të brendshëm, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se Universiteti " Haxhi Zeka" në Pejë me datë 06.03.2019 ka shpallur konkurs të brendshëm me nr.ref:UHZ-së/007/19 për pozitën "Sekretar i Njesisë Akademike-Fakulteti i MTHM". Komisioni Përzgjedhës pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, në Raportit Final form. Map-SHCK-11 të datës 25.03.2019, ka konstatuar së asnjëri nga kandidatet pjesëmarrës nuk ka arritur numrin e pikëve të kërkuara. Bazuar në Raportin Final të Komisionit Përzgjedhës, Zyra e Personelit ka ri inicuar procedurë të re rekrutimi për pozitën në fjalë, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 Për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civilë, përkatesisht nenin 35 pargarafi 3 dhe 4 ku parshihet se 3. Në rastet e përcaktuar në nenin paragrafi 5 të nenit 34, menaxheri i Personelit, pas konsultimit dhe miratimit nga Udhëheqësi më i lartë i institucionit, informon MAP-in. 4. Procedura e re e rekrutimit iniciohet brenda 10 ditëve., e si rrjedhojë pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor, se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil nuk është formuar në pajtim me Rregulloren Nr.02/010 për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civil, Kolegji ka analizuar Vendimin me numër protokolli 1210 të datës 16.05.2019 për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës për zhvillim të procedurave të rekrutimit për pozitën "Sekretar i Njesisë Akademike-Fakulteti i MTHM", dhe si rrjedhojë ka vlerësuar se Komisioni Përzgjedhës është themeluar në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/010 për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civil me të cilin është përcaktuar se: "Institucionet themelojnë një Komision Përzgjedhës ad hoc të Shërbimit Civil(në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarë të cilët kanë pozita më të lartë se pozita që duhet të rekrutohet , por një anëtarë mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor.., andaj pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Duke ju referuar pretendimit ankimor, se në testin me shkrim nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi i KPMSHC-së, siç parashihet me Rregulloren Nr.03/2018 Për Rregullat dhe Procedurat e Mbikëqyrjes së Përzgjedhjes së Nëpunësve Civil të Nivelit të Lartë Drejtues dhe Nivelit Drejtues, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se organi i punësimit përmes e-mailit zyrtar me datë 08.05.2019 dhe 22.05.2019, në pajtim me nenin 3 të kësaj Rregullore ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me shpalljen e konkursit, deklaratën për Formimin e Komisionit Përzgjedhës dhe datën e mbajtjes së testit me shkrim. E Meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka qenë funksional nga janari 2019, i njëjti nuk ka mundur të ushtroj funksionin e mbikëqyrjes së procedurave të përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit drejtues, duke përshirë edhe mbikëqyrjen e procedurës rekrutuese për pozitën "Sekretar i Njesisë Akademike-Fakulteti i MTHM" në Universitetin " Haxhi Zeka" në Pejë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, me rastin e vendosjes lidhur me ankesën e ankuesit të datës 25.06.2019 sipas Vendimit me numër protokolli 1943 të datës 22.07.201, ka shqyrtuar drejtë ankesën e ankuesit dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen e kontestuar.

Andaj, duke ju referuar rrethanave dhe fakteve si me lartë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën "Sekretar i Njesisë Akademike -Fakulteti i MTHM" e shpallur nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë është zhvilluar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.474/2019

Rushit Kajtazi

Procesmbajtëse

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesja,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë;
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin "Haxhi Zeka: në Pejë dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së